



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:139042

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06311848

C.nr.213/23

Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Nehat Qelaj, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina, në çështjen juridike të paditësve M.H.A.P.të punësuar ne SHFMU “Emin Duraku” në fshatin D., Komuna e Malishevës, të cilët me autorizim i ka përfaqësuar Av. Zahir Hamza nga Prishtina kundër të paditurës Komuna e Malishevës - Drejtoria e Arsimit, sipas bazës juridike, kompensim pagave jubilarë, jashtë seancës gjyqësore me datë 17.10.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

- I. Apropohet** në tërësi si e bazuar padia e paditësve M.H.A.P.të punësuar ne SHFMU “Emin Duraku” në fshatin D., Komuna e Malishevës.
- II. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria e Arsimit që paditësve në emër të pagave jubilarë tua kompenzojë si në vijim:
 - **Paditësit M.H.t** ia paguaj-kompensoj në emër të një (1) page jubilarë prej 50 % të përllagritura sipas pagës bazë në shumën e prej **210.50 euro**,
 - **Paditësit A.P.t** ia paguaj-kompensoj në emër të një (1) page jubilarë prej 50 % të përllagritura sipas pagës bazë në shumën e prej **210.50 euro**, me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt.25.04.2023, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- III. DETYROHET** e paditura që paditësve pjesërisht t’ua kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 208.00 euro, në emër të taksës shumën prej 20.00 euro ndërsa **REFUZOHET** pjesa tjetër e shpenzimeve të paditësve në emër seancave shumën prej 202.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësit M.H.A.P.të punësuar ne SHFMU “Emin Duraku” në fshatin D., Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit të tyre Av. Zahir Hamza nga Prishtina, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës - Drejtoria e Arsimit sipas bazës juridike kompensim i pagave jubilarë. sipas padisë paditësit janë të punësuar tek e paditura në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHFMU “Emin Duraku” në fshatin D., Komuna e Malishevës, paditësit e sipërshënuar i plotësojnë kushtet e përfitimit të pagave jubilarë sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, për çka pretendojmë se u takon kompensimi, gjykatës i kanë propozuar të aprovohet në tërësi si e bazuar padia e paditësit, ashtu që të detyrohet e paditura që në emër të një page jubilarë t’ia paguaj paditësi M.H.për 10 vite përvojë të punës prej 50% të pagës shumë prej 210.50 euro, paditësit A.P.për 10 vite përvojë të punës prej 50% të pagës shumë prej 210.50 euro me kamatë ligjore prej 8% deri në përmbartimin e aktgjykimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për parashtrimin e padisë t’ia paguaj shumë prej 208.00 euro, në emër të taksës e ka kërkuar, por nuk e ka precizuar dhe në emër të seancave shumë prej 202.00 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësve e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar duke e kontestuar padinë e paditësit si të pa bazuar, Komuna e Malishevës e konteston vlerën e borgjit lidhur më këtë qështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkeputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi, pasi që palet të cilet e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nashkruajt këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj ,e gjitha kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK më dt: 21.11.2022 për shkputjen e kësaj kontrate, poashtu, MAPL ka bërë njoftim për krytaret e komunave më dt: 22.11.2022 për shkputjen e kësaj kontrate nga MASHT për munges të bazës ligjore të kesaj kontrate kolektive, gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar, dhe kjo çështje kontestuese të zhvillohet nda Qeverisë së Republikës së Kosovës

Me qellim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata pa caktuar seancë gjyqësorë i shqyrtoi këto provave dhe atë: për paditësin A.P.vërtetimin e punës nr.01/709 të datës 06.04.2023, kontratën e punës nr.11/966 të datës 18.09.2018, për paditësin M.H.kontratën e punës nr.11/969 të datës 18.09.2018, vërtetimin e punës nr.01/710 të datës 06.04.2023 dhe listën e pagës për të gjithë paditësit.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura,

mirëpo kontestuese rezulton të mbetet kompensimi i mjeteve në emër të pagave jubilarë si në dispozitiv këtij Aktgjykimi edhe përkundër kërkesës së paditësit për kompensimin e të njëjtave, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas neni 35 paragrafi 8 në të cilën përcaktohet se **“Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) për vitet jubilarë të punësimit përfitojnë çmimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë dhe atë për 10 vite përvojë të punës në vlerën prej 50% të një page bazë, për 20 vite përvojë të punës në vlerë prej 75% të një page bazë, për 30 vite përvojë pune në vlerë të një page bazë dhe 40 vite të përvojës së punës në vlerën prej 150% të një page bazë, ndërsa shpërblimi jubilar paguhët nga punëdhënësi kur i punësuar ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve të nenit 8”**, kjo gjykatë vlerëson se paditësit i takon e drejta e në kompenzimin e pagave jubilarë sipas pagës bazë, faktë të cilin gjykata e vërtetoi me shiqimin e vërtetimit të punës.

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**

Njëkohësisht, meqenëse nga parashtresa e padisë u konstatua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve i përket kompensimit në emër të pagave jubilarë, megjithatë për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se **“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundëjt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”**, ndërsa në nenin 398 është përcaktuar se **“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”**, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i ka kontestuar fare faktet vendimtare përveç që është e kontestuar e drejta e kompensimit të të pagave jubilarë si e pa bazuar në kontratën kolektive, andaj meqenëse në rastin konkret e paditura në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, gjykata duke interpretuar të njëjtën me dispozitat e nenit 396 par.2 në të cilën përcaktohet se **“Po që se i padituri e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t’i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”**, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete

parashtrësës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj. Andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjendën në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë së paditësve.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me legjitimitetin e saj në procedurë, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësit sipas padisë kërkojnë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (25.04.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se **“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”** dhe Rregullores për tarifatat e Avokatëve, ashtu që vendosi që paditësve t’ua njoh shpenzimet e procedurës duke detyruar të paditurën që paditësve t’ia paguajë shumën prej 208.00 euro në emër të parashtrimit të padisë, në emër të taksës shumën prej 20.00 euro, ndërsa e refuzoi shumën prej 202.00 euro të kërkuar në emër të seancave sipas dispozitës së lartëcekur mbi shpenzimet procedurale.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 dhe 398 të LPK-së.

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë/Divizioni Civil
C.nr.213/23 me datën 17.10.2024

Gj y q t a r i
Nehat Qelaj

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosoves, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.